

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS**– kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Gani Zabeli, kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi e Hashim Çollaku, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Vjollca Kurtishaj në çështjen penale kundër të akuzuarit M.B. nga fshati ..., Komuna e Ferizajit, për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me ankesën e Përfaqësuesit të të dëmtuarit A.N., av. K.A., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, P.nr.751/2016 të datës 19.04.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 31.07.2018 mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Përfaqësuesit të të dëmtuarit A.N., av. K.A., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, P.nr.751/2016 të datës 19.04.2018, **vërtetohet**

### A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, me aktgjykimin P.nr.751/2016 të datës 19.04.2018, të akuzuarin M.B., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 4 të KPRK, për të cilën e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind), e të cilin dënim i akuzuari është detyruar që ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën do të ekzekutohet dënimi i shqiptuar me burgim konform nenit 46 par.3 të KPRK dhe për një ditë burgimi do ti llogaritet 20€. I dëmtuari A.N. nga Shtimja, rr. "Anton Çeta" është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike. I akuzuari është obliguar që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20 (njëzet) €, në emër të paushallit gjyqësor obligohet që të paguaj shumën prej 20 (njëzet)€, si dhe shumën prej 30€ në Fondin e mbrojtjes së viktimave në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë Përfaqësuesi i të dëmtuarit A.N., av. K.A., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi lartësisë e dënimit, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë dhe të akuzuarit ti shqiptojë dënim me burg efektiv i cili do të ishte në harmoni me rrethanat faktike të rastit konkret..

Prokurori i Apelit, me shkresën PPA/II.nr.782/2018 me datë 24.07.2018, ka propozuar që ankesa e Përfaqësuesit të të dëmtuarit A.N., av. K.A., të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ku i njëjti aktgjykim i ankimuar të ndryshohet sa i përket vendimit lidhur me sanksionin penale në atë mënyrë që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim mëi ashpër, ndërsa të hudhet ankesa përkitazi me shkeljen e ligjit penal.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

**- ankesa nuk është e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt komfor dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit A.N., av. K.A., me ankesë pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje të ligjit sepse i dëmtuari në rastin konkret pala e dëmtuar as nuk është njoftuar për seancën e shqyrtimit fillestar me ç'rast e njëjta është privuar nga e drejta e saj në kuptim të nenit 287 par.1 të KPPK.

Kolegji penal i kësaj Gjykate vlerëson se, sipas dispozitës së nenit 381 par. 3 të KPP “ i dëmtuari mund të ushtroj ankesë ndaj aktgjykimit vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurimit të trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale”.

Në rastin konkret vepra penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 4 të KPRK, bën pjesë në Kapitullin XVI, në grupin e veprave penale kundër jetës dhe trupit, pra, bën pjesë në grupin e veprave penale ku të dëmtuarit i lejohet ankesa vetëm ndaj vendimit mbi dënimin, prandaj ankesa përkitazi me shkelje të ligjit, hudhet si e pa lejuar.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit A.N., av. K.A., me ankesë pretendon se dënimi i shqiptuar në rastin konkret nga gjykata e shkallës së parë është mjaft i butë dhe jo adekuat në krahasim me veprën e kryer. Sipas ankesës, i akuzuari e ka pranuar fajësinë vetëm sa për të përfitur lehtësirat ligjore nga pranimi i fajësisë, sepse i akuzuari asnjëherë nuk ka kërkuar falje nga i dëmtuari dhe as që ka shprehur keqardhje dhe pendim për veprimet e kryera, prandaj edhe ka propozuar dënim më të ashpër.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e Përfaqësuesit të të dëmtuarit A.N., av. K.A., për shqiptimin e një dënimi më të ashpër, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me nenin 73 të KPPK-së, me ç'rast si rrethana lehtësuese në anën e të akuzuarit ka vlerësuar se e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës për kryerjen e veprës penale, se është i gjendjes së dobët ekonomike, se është mbajtës i familjes, se ka premtuar që në të

ardhmen nuk do të përsërisë veprën e kryer e as të ngjashme, se është pajtuar në polici me të dëmtuarin, sjelljen e mëparshme të të akuzuarit si dhe faktin se konflikti midis tyre ka qenë i rastit dhe se më parë të njëjtit nuk janë njohur.

Kjo gjykatë, vlerësimin e këtyre të rrethanave relevante të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, në fakt në ankesë nuk ceket asnjë rrethanë që nuk është vlerësuar më parë nga gjykata e shkallës së parë, e që sipas vlerësimit të kësaj gjykate do të ndikonte që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Pra, duke marrë parasysh mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe rrethanat tjera, kjo gjykatë vlerëson se dënimi të cilin të akuzuarit ia ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjeneralë , posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë në pajtim me dispozitën e nenit 400 e 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.776/2018 me datë 31.07.2018**

**Bashkëpunëtorja profesionale**  
**Vjollca Kurtishaj**

**Kryetari i kolegjit-gjyqtari**

**1. Gani Zabeli**

**Anëtarët e kolegjit:**

**2. Shqipe Qerimi**

**3. Hashim Çollaku**